



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:118567
Datë: 25.09.2024
Numri i dokumentit: 06205360

CA.nr.8903/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naime Ahmeti, kryetare e kolegjit, Halide Reka dhe Naim Mehulli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit Sh.I. nga fshati R., Komuna Ferizaj, të cilin me autorizim e përfaqëson V.M. avokat nga Ferizaji, kundër të paditurit Sh.S. nga fshati R., Komuna Ferizaj, të cilin me autorizim e përfaqëson B.S. avokat nga Ferizaji, për të pengim posedimit, duke vendosur sipas ankesës të ushtruar nga i autorizuari i të paditurit, e paraqitur kundër aktvendimit përmirësues të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2021:118567 datë 26.06.2024, si pjesë përbërëse e aktvendimit C.nr.2021:118567 datë 31.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 24.09.2024, morri këtë:

A K T V E N D I M

I.REFUZOHET e pathemeltë ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditësit Sh.I. nga fshati R., Komuna Ferizaj, ndërsa aktvendimi përmirësues i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2021:118567 datë 26.06.2024, si pjesë përbërëse e aktvendimit C.nr.2021:118567 datë 31.10.2023, VËRTETOHET.

II.Pika I (një) e dispozitivit të aktvendimit Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2021:118567 datë 31.10.2023, mbetet e pashqyrtuar.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin C.nr.2021:118567 datë 31.10.2023, në pikën I të dispozitivit ka vendosur: “Konstatohet e tërhequr padia e paditësit Sh.I. nga fshati R., Komuna Ferizaj, kundër të paditurit Sh.S. nga fshati R., Komuna Ferizaj, për pengim posedimi. Në pikën II të dispozitivit e ka obliguar paditësin që të paditurit t’ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 270.00€, në afat prej 15 dite nga pranimi i këtij aktvendimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë”.

Përfaqësuesi i të paditurit av.B.S. aktvendimin C.nr.2021:118567 datë 31.10.2023, e pranon me datë 09.11.2024, ndërsa me datë 10.11.2024, kërkon nga gjykata që të bëjë plotësimin-korigjimin e aktvendimit C.nr.2021:118567 datë 31.10.2023, gjegjësisht pikën II të dispozitivit

të tij që ka të bëjë me shpenzimet e procedurës sipas nenit 165 të LPK-së. Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas parashtrës të autorizuarit të paditurit për përmirësim-korrigjim, me aktvendimin C.nr.2021:118567 datë 26.06.2024, bënë përmirësimin e gabimit teknik në dispozitiv të aktvendimit 2021:118568, datë 31.10.2023, dhe atë në dispozitiv nën II, ku është shënuar gabimisht “OBLIGOHET paditësi që të paditurit t’ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 270.00€, në afat prej 15 dite nga pranimi të këtij aktvendimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë ” e që është dashur të jetë “OBLIGOHET paditësi që të paditurit t’ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 1,240.50€, në afat prej 15 dite nga pranimi i këtij aktvendimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë. Në pjesët tjera aktvendimi mbetet i pandryshuar”.

Kundër këtij aktvendimi edhe pse pa të drejtë ankese, brenda afatit që ka qenë dashtë të jetë i paraparë në këshillën juridike, ankesë ka parashtruar përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar jo të drejtë të gjendjes faktike, lidhur me shpenzimet e procedurës, me propozim që Gjykata e Apelit me rastin e analizimit të dosjes me ankesë të veproj sipas detyrës zyrtare në këtë çështje për shkak të cenimit të rëndë të ligjit dhe vet sigurisë juridike në dëm të palës-paditësit.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se:

-Ankesa është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi Sh.I. përmes të autorizuarit të tyre av. V.M., me datë 05.03.2020, ka paraqitur padi kundër të paditurit Sh.S. nga fshati R., Komuna Ferizaj, me bazë juridike pengim posedimi.

Në seancën gjyqësore të datës 11.10.2022, i autorizuari i paditësit Sh.I., av. V.M. ka deklaruar se në këtë fazë të procedurës e tërheqin padinë lidhur me këtë çështje juridike kontestimore, për arsye se jemi duke zhvilluar edhe procedurën tjetër lidhur me çështjen e servitutit në këtë gjykatë. Ndërsa i autorizuari i të paditurit av. B.S. është pajtuar me tërheqjen e padisë, mirëpo i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë ka marrë aktvendimin me të cilin në pikën një e ka konstatuar të tërhequr padinë e paditësit dhe në pikën dy ka vendosur për shpenzimet e procedurës, më pastaj sipas kërkesës të të autorizuarit të paditurit ka marrë aktvendimin e ankimuar me të cilin ka bërë përmirësimin e aktvendimit kryesor, gjegjësisht pikën dy të tij, duke vendosur sipas shpenzimeve të specifikuar, ndërsa pjesët tjera të aktvendimit kryesor ka theksuar se mbeten të pandryshuara.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar se, edhe pse gjykata e shkallës së parë aktvendimit të atakuar nuk i ka dhënë të drejtë ankese, duhet vlerësuar ankesën e ushtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i paditësit av.V.M., për arsye se me dispozitën e nenit 206 paragrafi 2 të LPK-së, është e përcaktuar se: *“Po që se me këtë ligj parashihet shprehimisht se ankimi i veçantë nuk*

lejohet, aktvendimi i shkallës së parë mund të goditet vetëm me anë të ankesës që paraqitet kundër vendimit me të cilin përfundon procedimi i çështjes në gjykatën e shkallës së parë”.

Në rastin konkret Gjykata e Apelit, vlerëson se procedura në këtë çështje juridiko civile ka përfunduar me tërheqjen e padisë nga ana e paditësit, mirëpo lëshimi nga ana e gjykatës së shkallës së parë ka qenë se me rastin e vendosjes si në pikën II të dispozitivit të aktvendimit C.nr.2021:118567 datë 31.10.2023, nuk është lejuar ankesa, sepse gjykata ka qenë e obliguar që të japë këshillin juridike, për arsye se vendimi për shpenzimet është vendim i posaçëm dhe në çdo rast lejohet ankimi i posaçëm sipas dispozitës së cituar më lartë.

Gjykata e Apelit me rastin e vlerësimit të pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesën e të autorizuarit të paditësit se sa i përket vendosjes lidhur me shpenzimet e procedurës si në aktvendimin e ankimit i cili është përmirësuar –korrigjuar për palën e paditur, ka vlerësuar se janë pretendime të pabazuara, sepse tek Kreu i XV i Ligjit për Procedurën Kontestimore, janë të përcaktuara përbërja e shpenzimeve të procedurës, ndërsa me dispozitën e nenit 456 paragrafi 1, është e përcaktuar se: *‘Paditësi që e tërheqë padinë ka për detyrë që të paditurit t’ia shpërblejë shpenzimet procedurale përveçse kur tërheqjen e padisë e ka bërë menjëherë pas përmbushjes së detyrimit nga ana e të paditurit’*, në rastin konkret çështja kontestuese ka qenë pengim posedim dhe i padituri nuk ka dhen shkas padisë së paditësit.

Duke qenë se çështja kontestuese në procedurën në gjykatën e shkallës së parë është vendosur një herë nga ajo gjykatë sipas aktvendimit C.nr.1472/2021 të datës 11.10.2021, me të cilën është aprovuar kërkesëpadija e paditësit, ndërsa i padituri është obliguar në mbulimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore, mirëpo sipas ankesës të autorizuarit të paditurit çështja është shqyrtuar nga Gjykata e Apelit e cila ka marrë aktvendimin Ac.nr.6087/2022 të datës 22.05.2023, me të cilin është aprovuar ankesa e palës së paditur dhe çështja është kthyer në rigjykim dhe rivendosje. Në seancën e rivendosjes është tërhequr nga padia paditësi meqë në procedurën tjetër në atë gjykatë është duke u zhvilluar procedurë lidhur me çështjen e servitutit, ndërsa që përfaqësuesi i autorizuar i të paditurit në fjalën përfundimtare të procedurës së parë ka precizuar shpenzimet e procedurës si palë në procedurë, e po ashtu edhe në procedurën e rigjykimit është deklaruar se nuk e kundërshton tërheqjen por i kërkon shpenzimet e procedurës, në këtë rast të paditurit i takojnë shpenzimet e procedurës, duke qenë se ai nuk i ka dhënë shkas padisë së iniciuar nga paditësi. Andaj Kolegji i Gjykatës së Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke e refuzuar ankesën e të autorizuarit të paditësit të pathemeltë, meqë u lëshua në vlerësim të ankesës, dhe jo në hudhje të saj, duke e trajtuar ankesën e paraqitur, për faktin se vendimi mbi shpenzimet çdo herë duhet të ketë këshillën juridike, e drejtë e cila është e garantuar me dispozitat materiale të Ligjit për Procedurën Kontestimore, Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Me dispozitën e nenit 163 paragrafi 3, i LPK-së është e përcaktuar se: *“Në qoftë se propozimi për plotësimin e aktgjykimit ka të bëjë vetëm me shpenzimet e procedurës, aktvendimin mbi propozimin e jep gjykata pa caktuar seancë gjyqësore”.*

Gjykata e shkallës së parë, lidhur me shpenzimet e procedurës, ka vendos duke u bazuar në dispozitat e neneve 452.1, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, lidhur me tarifën e OAK-së, duke e detyruar paditësin që të paditurit të ia paguaj dhe atë: shumën prej 914.00 euro nga procedura e mëparshme, taksën gjyqësore për ankesë shumën prej 30.00 euro dhe parashtrimin të ankesës ndaj vendimit të mëparshëm shumën prej 208 euro dhe shpenzimet për përfaqësim në shumë prej 67.50 euro në seancën që është tërhequr padia, gjithsej shumën prej 1,240.50 €.

Gjykata e Apelit, aktvendimin e korigjuar, të goditur me ankesë, të gjykatës së shkallës së parë lidhur me shpenzimet e aprovuara e vlerëson si të rregullt dhe të bazuar në ligj për shkak se me rastin e vendosjes i është referuar Tarifës së Odës së Avokatëve (Rregullore për TA e nxjerrë nga Oda e Avokatëve të Kosovës me datë 18.03.2017), me të cilën Rregullore në nenin 1 është përcaktuar se: *‘Me këtë Rregullore përcaktohen pagesat tarifat për punën e avokatëve dhe kompensimin e shpenzimeve për punën e avokatëve’*, ashtu që përfaqësuesi i të paditurit av. Bekim Sylejmani në procedurën e parë me parashtrësën e datës 16.09.2021 ka precizuar shpenzimet e procedurës të cilat i janë shkaktuar të paditurit, e po ashtu edhe në seancën e rigjykimit në të cilën është tërhequr padia nga paditësi, i ka kërkuar shpenzimet e procedurës sipas tarifës së OAK-së.

Sipas Gjykatës së Apelit, Tarifa e Avokatëve e cila është aplikuar nga Gjykata e shkallës së parë, drejtë është zbatuar, pasi që shpenzimet të cilat të paditurit si palë që nuk i ka dhen shkas padisë i janë shkaktuar gjatë procedurës kontestimore, ligjërisht duhet ti kompensohen nga pala e cila ka humbur apo është tërhequr nga padia (neni 456.1 i LPK-së), që në rastin konkret është dashtë që t'i njihen shpenzimet që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq dhe me fajin e kujt janë krijuar ato shpenzime, gjithnjë duke ju referuar listës së shpenzimeve të kërkuara nga pala të cilës i janë krijuar shpenzime gjatë procedurës së udhëhequr.

Më dispozitën e nenit 449 të LPK shprehimisht parashihet *„ Shpenzimet procedurale përbëhen nga harxhimet e bëra gjatë dhe lidhur me procesin gjyqësor, ku shpenzimet procedurale përfshijnë edhe shpërblimet për punën e avokatit e të personave të tjerë të cilëve ligji i jep të drejtën e shpërblimit ‘Ndërsa më dispozitën e nenit 452.1 të LPK shprehimisht parashihet se „ Pala e cila ka humbur procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtarë gjyq fituese, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t’ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore ‘*.

Përfundimisht, Gjykata e Apelit i ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, por nuk ka gjetur se ekziston ndonjë shkelje e cila do të ndikonte që vendimi të kualifikohet si i tillë për çka çështja pastaj do të duhej të kthehej në rishqyrtim.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 pika (b) e LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CA.nr.8903/2024, më datë 24.09.2024

Kryetare e kolegjit
Naime Ahmeti, d.v.